

KONFERENCA E ICMP
“ADRESIMI I ÇËSHTJES SË PERSONAVE TË ZHDIKUR NGA KONFLIKTI NË KOSOVËT”
16 - 17 MAJ 2007
HOTEL METROPOL, OHRËR, MAQEDONI

KONKULZIONET

Rreth 65 përfaqësues të shoqatave familjare dhe përfaqësues të komisioneve qeveritare për persona të zhdukur që përfaqësonin të gjitha komunitetet, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, active në procesin e zgjidhjes së çështjes së personave të zhdukur si dhe organizata tjera qeveritare dhe joqeveritare, u mbledhën për të dëgjuar të dhënat e fundit në lidhje me progresin e gjertanishëm të përcaktimit të fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur, për të shqyrtuar kornizat ekzistuese dhe të mundshme institucionale për adresimin e çështjes, dhe për të diskutuar pritjet, nevojat dhe kontributin e mundshëm të të gjitha palëve të involvuara. Ata u pajtuan për konkluzionet në vijim:

1. Është imperative që të gjitha informacionet që mbahen nga, *inter alia*, ICTY, KFOR (NATO), UNMIK, ICMP, ICRC, institucionet e përkohshme të vetqeverisjes dhe të Qeverisë së Serbisë, të cilat mundë të ndihmojnë në përcaktimin e fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë, duhet dhënë dhe konsoliduar duke marre parasysh mbrojtjen e te dhenave personale. Kjo duhet të vlejë edhe për organizatat jo qeveritare. Në këtë drejtim, implementimi I ligjit duhet të bëhet urgjentisht, *inter alia*, Serbi dhe Kosovë.
2. Informatat e kopsoliduara duhet të verifikohen dhe baza e të dhënave duhet krijuar. Këto të dhëna duhet të mirëmbahen dhe të azhurnohen nga autoritetet relevante Qeveritare – Komisionet për Persona të Zhdukur.
3. Familjarët e të zhdukurve kërkojnë përgjigje të menjëhershme sa I përket fatit të të gjithë personave të burgosur dhe zhdukur. Është imperative që të gjitha informacionet në lidhje me dyshimet për burgosjet e paligjshme duhet t’u prezantohen shoqatave familjare të të zhdukurve nga Kosova, pa asnjë vonesë..
4. Të gjitha konventat relevante ndërkombëtare duhet të rrespektohen në tërësi, duke përfshirë këtu, por jo vetëm, Konventat e Gjenevës dhe Protokolet shtesë, Konventën Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike., Konventën Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, sociale dhe Kulturore, dhe Konventa Kundër Torturës, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve si dhe Konventat Evropiane për të Drejtat Themelore të Njeriut. Autoritetet relevante duhet të kalojnë dhe implementojnë ligjet të cilat në tërësi I mbrojnë të gjitha të drejtat civile, kulturore, ekonomike, sociale dhe politike, të familjeve të personave të zhdukur.
5. Procesi I gërmimeve, zhvarrimeve dhe identifikimeve të personave të zhdukur duhet të intensifikohet. Kjo nënkupton prezencën e detyrueshme të komisioneve për persona të zhdukur, ekspertëve mjekoligjorë, dhe të ICMP në përputhje me lejen e autoriteteve relevante gjyqësore për çasje në vendzhvarrime:

- Të gjitha varrezat e ditura duhet të ekshumohen sa më shpejtë që është e mundur;
- Duhet intensifikuar kërkimi për varreza të reja shtesë;
- Duhet hulumtuar dhe raportuar publikisht të gjitha dyshimet për trupat e djegur;
- Mundësia e identifikimeve jokorrekte duhet të shqyrtohet dhe të adresohet përmes procesit konsultativ. Kjo duhet të përfshijë rastet e trupave të varrosur nga familjet pa ekspertizë mjekoligjore dhe ose pa dokumentacion përkatës ligjor- certifikatat e vdekjes.

6. Duhet të vendoset bashkëpunimi me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë, në mënyrë që të lokohen dhe zhvarrosen çdo mbetje mortore e të zhdukurve nga konflikti në Kosovë të cilat mundë të ndodhen në këto teritore. Monitorimi ndërkombëtarë duhet të nxisë transparencën në proces.
7. Bashkëpunimi në mes të shoqatave familjare të personave të zhdukur pavarësishtë përkatsisë etnike ose tjetër, duhet të zhvillohet dhe fuqizohet më tutje. Duhet të intensifikohet komunikimi i rregullt në mes të shoqatave familjare dhe Komisioneve për persona të zhdukur në Beograd dhe Prishtinë si dhe të delegacioneve të *Grupeve Punuese për personat e Pagjetur në lidhje me ngjarjet në Kosovë* (Grupet Punuese). Si përfundimi, duhet krijuar nëngrupi punues i cili duhet të përfshijë shoqatat familjare të të gjitha komuniteteve, perms të cilave do të ofrohej informacioni kthyes i rregullt dhe në kohë.
8. Të gjitha informatat si kurse janë dokumentacioni, rrethanat, koha vendi i zhdukjes, të cilat do të mundë të ndihmonin kërkimin e personave të zhdukur, duhet t'ju ofrohet komisioneve relevante qeveritare në mënyrë që ato të përcillen perms të mekanizmave si Grupet Punuese. Në veçanti, duhet të kërkohen informata nga KFOR dhe ICTY në lidhje me trupat e zhvarrosur gjatë vitit 1999.
9. Bashkëpunimi në mes të shoqatave familjare, komisioneve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare si UNMIK, ICMP, ICRC duhet të inkurajohet dhe të vazhdohet edhe në të ardhmen.
10. ATë gjitha trupat relevant (policia, prokuroria dhe gjykatat) duhet të ndërmarrin dhe të intensifikojnë përpjekjet në lidhje me hulumtimet dhe përndjekjet e besueshme në të gjitha rastet e krimeve të luftës ose shkeljes së të drejtave të njeriut. Familjarët kërkojnë ndërmarrjen e hapave në dërtim të njohjes formale të ngjarjeve të së kaluarës dhe formave tjera të raparacioneve dhe njohjes.
11. Përfshirja e publikut dhe ndërgjegjsimi për çështjen e personave të zhdukur, duhet të rritet perms aktiviteteve mediatike në Serbi dhe Kosovë. Tata të cilët në mënyrë direkte janë të përfshirë në process duhet të ofrojnë informata të sakta perms kontakteve me media.
12. Leksionet e mësuara dhe metodologjitë e punës në kërkimin e personave të zhdukur në ish Jugosllavi, e posaçërishtë në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci, si dhe në vendet e tjera duhet të shkëmbehen dhe të shfrytëzohen përparsitë e tyre.
13. Paqja mundë të arrihet vetëm perms drejtësisë.